



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-5926 /2025

Klinë, datë 24/02/2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më dt. 04.06.2008, nr.28, dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-049, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.04/2023 për Administrate të Hapur në Komunë, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

V E N D I M

Për formimin e grupit punues për hartimin e draft KAB 2026-2028

1. **CAKTOHET**, grupi punues për hartimin e projekt dokumentit- Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028.
Përbërja e grupit punues do të jete si në vijim:
 - 1.1. Melihate Behramaj, ZKF kryesuese;
 - 1.2. Enver Berisha, Drejtoria e Urbanizmit, anëtarë;
 - 1.3. Enver Berisha, Drejtoria e Financave, anëtare;
 - 1.4. Vlora Tafili, zyrtare për informim, anëtare;
 - 1.5. Nikson Daka, Drejtoria e Kadastrit, anëtarë;
 - 1.6. Mirsad Dakaj, këshilltar i kryetarit, anëtarë si dhe;
 - 1.7. Viktor Kuqi, asistent administrativ, anëtare.
2. Grupi punues është përgjegjës për hartimin e draft dokumentit- KAB 2025-2027, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga diskutimet publike dhe vendosjen lidhur më pranimin apo jo të tyre, hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera që dalin nga dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, nr.04/2023 për Administrate të Hapur në Komunë, si dhe autorizimeve tjera ligjore e nënligjore.
3. Me rastin e përgatitjes dokumentit në bashkepunim edhe me konsulentët vullnetar, njoftohet kryetari i komunës me qëllim të procedimit të tij për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Komunës.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Drejtoria e Financave;
- Zyrtarja përgjegjëse e konsultimeve publike, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj





Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 112-5600/2025

Klinë, datë 26/02/2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më dt. 04.06.2008, nr.28, dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr.03/L-049, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Kryetari i Komunës së Klinës me qëllim të plotësimit të vendimit baze edhe më 2 anëtarë, mori këtë;

V E N D I M

Për plotësimin e vendimit nr.01-112-5600/2025 të datës 24.02.2025 për formimin e grupit punues për hartimin e draft KAB 2026-2028

1. **PLOTËSOHET**, vendimi baze, nr.01-112-5600/2025 i datës 24.02.2025 për themelimin e grupi punues për hartimin e projekt dokumentit- Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028. Paragrafit 1 të vendimit baze i shtohen edhe dy nen paragrafë 1.8 dhe 1.9 ku pjesë e grupit punues sipas vendimit baze do të jenë edhe:
 - 1.8. Arbëresha Tanushi, zyrtare e lartë për buxhet dhe financa, si dhe
 - 1.9. Njomza Jaha, analiste e lartë e buxhetit.
2. Ky vendim është pjesë perberese e vendimit baze, nr.01-112-5600/2025 të datës 24.02.2025.
3. Pjesët tjera të vendimit baze mbasin të pandryshueshme.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues janë të parapare sipas vendimit baze.
5. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Grupi punues;
- Drejtoria e Financave;
- Zyrtarja përgjegjëse e konsultimeve publike, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Elezaj

